# DËSHMI ARKIVI

**A-479400**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Von Der Leyen mbërrin të mërkurën në Tiranë, takon Ramën dhe Begajn |
| ADRESA | `https://kohajone.com/aktualitet/von-der-leyen-mberrin-te-merkuren-ne-tirane-takon-ramen-dhe-begajn/` |
| BURIMI | kohajone.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 29 shtator 2026, 13:42:50 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 29 shtator 2026, 13:30:18 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `5e94d6195bc31f140a8780375c8b43a1bb413cc639e68a9adf5c3aa5c9c32eb1` |
| TEKSTI | `0285931121280920df44b2034246341b1794e2bc3b5826d4936f962a189b0af9` |
| PAMJA | `18f782675fd5a1cc10068c562c3ff20af368d36287187dc772e0b4d708691544` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `5f099bedccf7eeefa3dd2baab7fb5f9d528f0b199b578f35c12ebad49b239163` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `5df8b09a82e67beafe6b324836ab8231b0f747e1cb5c8d4c8cb1ac702cd5a645` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/5f099bedccf7eeefa3dd2baab7fb5f9d528f0b199b578f35c12ebad49b239163`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Von Der Leyen mbërrin të mërkurën në Tiranë, takon Ramën dhe Begajn

AKTUALITET E MARTË, 29 SHTATOR 2026 15:30



Presidentja e Komisionit Europian, Ursula von der Leyen, mbërrin pasditen e së mërkurës në Tiranë, në kuadër të një turi në Ballkanin Perëndimor. Vizita e saj në Shqipëri nis rreth orës 16:00. Takimi i parë do të jetë me kryeministrin Edi Rama, me të cilin pritet të zhvillojë edhe një konferencë të përbashkët për shtyp rreth orës 17:00. Më pas, në orën 18:30, von der Leyen do të takohet me Presidentin e Republikës, duke përmbyllur axhendën e saj në Tiranë përpara se të vijojë vizitën në Malin e Zi.

Vizita zhvillohet në një periudhë kur zgjerimi i Bashkimit Europian duket se po hyn në një fazë të re. Sipas raportimeve të mediave ndërkombëtare, Brukseli po shqyrton mundësinë e përcaktimit të afateve më konkrete për disa prej vendeve kandidate, mes tyre Shqipëria, Mali i Zi, Ukraina dhe Moldavia. Këto katër vende konsiderohen ndër kandidatët që synojnë të avancojnë më shpejt drejt anëtarësimit, ndërsa procesi vijon të përballet me reforma të papërfunduara dhe pasiguri mbi afatet përmbyllëse të negociatave.

Sipas raportimeve, dokumentet që po përgatiten në Bruksel mund të sjellin për herë të parë një orientim më të qartë mbi kohën e përfundimit të negociatave. Ideja është që vendet që përmbushin reformat dhe detyrimet e përcaktuara të kenë një perspektivë më të konkretizuar për anëtarësimin. Në të njëjtën kohë, një tjetër element i diskutimit lidhet me mënyrën se si do të funksionojë BE-ja pas një zgjerimi të mundshëm.

Radio Evropa e Lirë, duke iu referuar një drafti të dokumentit të përgatitur nga Komisioni Europian, raporton se po shqyrtohen mekanizma që do të kufizonin, gjatë viteve të para të anëtarësimit, mundësinë e shteteve të reja për të bllokuar vendimmarrjen e BE-së. Sipas të njëjtit draft, shtetet anëtare ekzistuese do të kishin gjithashtu mekanizma për të reaguar në rast se një vend i ri devijon nga detyrimet e pranuara gjatë procesit të anëtarësimit.

Ndryshime të mundshme parashikohen edhe në përbërjen e Komisionit Europian. Sipas raportimeve, një prej propozimeve është reduktimi i numrit të komisionerëve, nga një për çdo shtet anëtar, në një numër që do të përfaqësonte

## LAJMET KRYESORE


Vlora Hyseni nuk qëndron duarkryq, nis betejën me drejtësinë


Rama në Samitin e Euronews 2026: Shqipëria është një nga vendet më të sigurta në Evropë


Këshilli Bashkiak kërkoi Veliajn në mbledhje, SPAK refuzon kërkesën



OpenAI anulon lëshimin e modelit të ri të inteligjencës artificiale për shkak të sigurisë


Gazment Bardhi: Lideri i PD duhej të ishte në mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare

## TË PËRZGJEDHURA

1


OpenAI anulon lëshimin e modelit të ri të inteligjencës artificiale për shkak të sigurisë

2

PREMIER LEAGUE – Po sikur Manchester City-t t'i hiqen të gjitha titujt? Si do të ndryshoni...

3

Singapori paguan qytetarët për të lexuar: 15 minuta në ditë në këmbim të parave

4

David Beckham merr 39 milionë paund divident, marrëveshjet e Kupës së Botës nxisin fitime rekord

5

Ish-ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu te Nikoll Lesi: Nuk ka ministra hije! Balluku-lokomotivë shtetfo...

## MË TË LEXUARAT

rreth dy të tretat e vendeve, përmes një sistemi rotacioni të barabartë.

Në këtë kontekst, vizita e von der Leyen në Tiranë merr një rëndësi të veçantë për Shqipërinë, e cila vijon procesin e negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Europian. Takimet në Tiranë pritet të shërbejnë edhe si një mundësi për të diskutuar ecurinë e reformave, hapat e ardhshëm të negociatave dhe perspektivën europiane të vendit.

ETIKETA BEGAJ RAMA VON DER LEYEN

## MË SHUMË NGA AKTUALITETI

**Rama thumbon nga Brukseli: Dua e do protestën, unë dua Duan. Ajo ësht...**

**Të shtënat në Krujë, Policia: Efektivi qëlloi në ajër**



**Kredi të buta dhe qira të subvencionuara, ministrja Ibrahimaj për pro...**



**Vlora Hyseni nuk qëndron duarkryq, nis betejën me drejtësinë**



**Rama në Samitin e Euronews 2026: Shqipëria është një nga vendet më të...**



**Ibrahimaj: Pasqyra e Çmimeve, gati në tetor me 160 produkte**

## LAJMET E FUNDIT



**VIDEO/ Gazment Bardhi poston investigimin: Balluku qeveris nga palestra, SPAK-u hesht përballë 14 akuzave**

3 MINUTA MË PARË



**Von Der Leyen mbërrin të mërkurën në Tiranë, takon Ramën dhe Begajn**

12 MINUTA MË PARË



**Brazili fiton me poker ndaj Australisë, por humbet Raphinha-n**

18 MINUTA MË PARË




**UEFA shpërblen klubet për Ligën e Kombeve, shpërndahen 31.5 mln euro**

35 MINUTA MË PARË

**Rama thumbon nga Brukseli: Dua e do protestën, unë dua Duan. Ajo është këngëtare, jo Papa**

35 MINUTA MË PARË



**146 pyetje për Begajn dhe Ramën, PD kërkon transparencë për emërimin e Vlora Hysenit në krye të SHISH**

51 MINUTA MË PARË

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.